

# Kontribute për shpëtimin e Pallatit "Skanderbeg"

"Lidhja nazionale e shoqatave shqiptare dhe arbëreshe në Itali" arrin suksesin e parë në fushatën e nisur për mbrojtjen e rezidencës romane të Heroit tonë Kombëtar, pallatit "Skanderbeg". E gjendur në sheshin me të njëjtin emër nr. 117 në Romë kjo rezidencë rrezikon të zhduket përjetësisht nga memoria jonë kolektive. Kjo për arsye të urdhërit të Kryebashkiakut Walter Veltroni për ta shndërruar këtë pallat, simbol për 7 milionë shqiptarë e për mëse 1 milionë arbëresh, në Muze Kombëtar të Makaronave në rindërim të guzhinierit të famshëm italian Vincenzo Agnesi. Që prej fillimit të fushatës

sensibilizuese që "Lidhja" ka ndërmarrë në fillim të dhjetorit 2004 përmes vënies në dispozicion të vlerës së 500 kopjeve të librit të botuar në Itali nga Presidenti i "Lidhjes" Alban Kraja, " Skanderbeg-La campagna d'Italia ", njoftojmë se deri më datën 10 janar '05 numri i kopjeve të shitura përmes internetit ka arritur në 157 libra, për një vlerë 3.611,00 euro. Shumë kjo, ndonëse simbolike, do të vihet në dispozicion të Komitetit për shpëtimin e monumentit, i cili do të impenjohet në vazhdim për rehabilitimin e pallatit të Skënderbeut. Ndaj me këtë rast kërkojmë edhe një herë solidaritetin

e opinionit publik e sidomos të organizmave qeveritare e partiake të Shqipërisë (që çuditërisht vazhdojnë të heshtin) që të gjithë sëbashku të gjejnë mënyrat për të mbrojtur identitetin dhe simbolet tona kombëtare. Duke pasur bindjen logjike, që vetëm të bashkuar mund të fitojmë betejën lidhur me rikthimin e objektit në fjalë akademikëve, historianëve e albanologëve tanë. Kush dëshiron të shprehë solidaritetin e tij në lidhje me sa më sipër është i lutur të kontaktojë "Lidhjen" në: [www.legaalbanese.com](http://www.legaalbanese.com)

Dott.ssa Cristina ZOLI  
Rimini: 11.01.2005